



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 15 janar 2013

Numri i lëndës: 2012-07

Faik Ibishi

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 14 dhe 15 janar 2013, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 29 qershor 2012.

II. FAKTET

2. Parashtruesi i ankesës pohon se ka dijeni për ekzistimin e një rrjeti pedofilie të gjerë dhe me ndikim në Kosovë, ku janë të përfshirë qytetarët vendas dhe ndërkombëtarë, përfshirë stafin e EULEX-it. Megjithatë, nga pretendimet e tij nuk duket se ai, të afërmit e tij apo ndonjë person tjetër në mbikëqyrjen e tij të supozohen se kanë qenë viktimë të veprimtarive të supozuara të këtij rrjeti kriminal.
3. Ai thotë se prej vitit 2007 ka bërë përpjekje t'i bind fillimisht organet hetimore të UNMIK-ut e pastaj të EULEX-it që t'i fillojnë hetimet lidhur me aktivitetet e këtij rrjeti të supozuar pedofilie. Ai pohon se të gjitha deklaratat e tij dhe dëshmitë e paraqitura nga ai janë injoruar dhe se si UNMIK-u ashtu edhe EULEX-i kanë refuzuar kryerjen e një hetimi.

III. ANKESAT

4. Duke mos e përmendur asnjë dispozitë konkrete të instrumenteve të drejtave të njeriut, parashtruesi i ankesës pretendon se EULEX-i refuzon të fillojë hetimet penale lidhur me aktivitetet e këtij rrjeti pedofilie, gjë që, sipas parashtrësve të tij, përbën shkelje të neneve 2 dhe 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa").

IV. LIGJI

5. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
6. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
7. Përkitazi me domethënien e fjalës "viktimë", Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në shumë raste ka vlerësuar se "viktima" sipas kuptimit të Konventës do të thotë personi i prekur drejtpërsëdrejti nga një veprim apo mosveprim (shih, mes shumë autoritetesh, *Amuur kundër Francës*, 25 qershor 1996, § 36, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1996-III). Në disa raste, kur ekziston lidhja personale dhe specifike ndërmjet viktimës së drejtpërdrejtë dhe parashtruesit të ankesës, Gjykata i ka pranuar parashtrësat nga ndonjë person, i cili është konsideruar viktimë e tërthortë. Nëse një person është ose jo viktimë e këtillë do të varet nga ekzistimi i faktorëve specialë të cilët i japin vuajtjeve të parashtruesit të ankesës një dimension dhe karakter të ndryshëm nga shqetësimi emocional i

cili mund të konsiderohet se u është shkaktuar pashmangshmërisht të afërmeve të një viktime të një shkelje të rëndë të drejtave të njeriut. Elementet përkatëse do përfshijnë, mes tjerash, ekzistimin dhe afrinë e lidhjes familjare, rrethanat e veçanta të raportit, shkallën deri në të cilën personi ka qenë dëshmitar i ngjarjeve në fjalë (shih, *mutatis mutandis*, *Kurt kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 25 maj 1998, Raportet 1998-III, §§ 130-134; *Yaşa kundër Turqisë*, aktgjykimi i datës 2 shtator 1998, Raportet për Aktgjykimet dhe Vendimet 1998-VI, § 71; dhe anasjelltas, *Çakıcı kundër Turqisë* [GC], nr. 23657/94, §§ 98-99, GJEDNJ 1999-IV). Paneli e konsideron të përshtatshme që qasjen e zhvilluar nga GJEDNJ ta miratojë si të vetën. Prandaj, Rregullorja e Punës nuk e parasheh nxjerrjen e një *actio popularis*; ajo nuk i lejon individëve që të parashtrajnë ankesë *in abstracto* kundër veprimeve dhe mosveprimeve të supozuara të EULEX-it për shkakun e thjeshtë se ata mendojnë se të njëjtat janë cenim e ti drejtave të njeriut.

8. Prandaj, Paneli konstaton se parashtruesi i ankesës nuk mund të pretendojë se është viktimë e ndonjë shkelje të drejtave të njeriut nga misioni EULEX në Kosovë sipas Rregullës 25, paragrafi 1 e Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli konsideron njëzëri se nuk e ka kompetencën për shqyrtimin e kësaj anekese, konstaton se kjo ankesë është e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese